



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Ekstrakt

i procesverbalit nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 17 dhjetor 2019

Takimi filloi në orën 10.00

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veli, Kryetar i Komunës.

Në takim ishte i pranishëm një numër i konsideruar i qytetarëve (59 pjesëmarrës), përfaqësues të OJQ-ve, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësues të OSBE-së, dhe mediat.

Tema:

➤ Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2019

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Qytetarë të nderuar ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë takim.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe të Statutit të Komunës ju kam ftuar këtë takim për t'ju informuar lidhur me realizimin e projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2019.

Pra qëllimi i këtij takimi është që qytetarët dhe subjektet tjera të Komunës së Podujevës të informohen në detaje rreth punëve dhe projekteve të realizuara në vitin 2019. Sa për informim projektet e miratuara në Kuvend për vitin 2019 janë realizuar apo janë në përfundim të realizimit sipas planit dinamik. Buxheti i Komunës për këtë vit ka qenë 22,032,619 €, prej të cilave 6701334 € kanë qenë për investime kapitale ndërsa në kategorinë e subvencioneve 570,000 €. Edhe në këtë vit investimet kapitale kanë qenë të orientuara në projektet e ndërtimit dhe rregullimit të infrastrukturës të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës sonë. Në vazhdim do të ju njoftoj rreth procesit të realizimit të disa prej projekteve kapitale.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka realizuar, përkatësisht ka në përfundim këto projekte: Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse (ndriçim publik, kanalizim të ujërave të zeza, kanalizim atmosferik, rrjet të ujësjellësit, sinjalizim horizontal dhe vertikal, urën mbi lumin Llap afër kompleksit banesor “ Malësia”), projekt në përfundim; Asfaltimi i rrugës Shajkoc- Xeherore, projekt i përfunduar; Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Zahir Pajaziti”, përfshirë infrastrukturën përcjellëse, projekt në përfundim; Asfaltimi i rrugës në fshatin Dumnicë e Epërme dhe Dumnicë e Poshtme –Loto 1, projekt i përfunduar; Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dobratin, projekt dyvjeçar 2018-2019, projekt i përfunduar; Ndërtimi i disa rrugicave me kubëza të betonit në lagjet e qytetit, projekt i përfunduar; Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Obrancë, lagja Rrzhana, projekt i përfunduar; Rregullimi i hapësirave të gjelbëruara, projekt në fazën e punimeve, mjetet e parapara për vitin 2019 janë në përfundim; Asfaltimi i rrugëve në

fshatin Godishnjak-Lluzhan, projekt i përfunduar; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopojë, projekt në fazën e punimeve; Hartimi i projektit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës, projekti i përfunduar; Asfaltimi i rrugës lidhëse në fshatrat Buricë-Penuhë dhe i disa rrugëve në fshatin Sfeçël, projekt i përfunduar; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Gllamnik, Llapshticë - Loto 3, projekt i përfunduar; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Dumnicë dhe Sfeçël, projekt në fazën e punimeve; Asfaltimi i rrugëve në Pakashticë - Qenogë, projekt i përfunduar; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shajkoc, Batllavë, Sfeçël, Balloc, Lladoc, projekt i përfunduar; Asfaltimi i rrugës në fshatrat Ballaban-Orllan; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dyz, projekt i përfunduar; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shajkoc, Batllavë, Sfeçël, Balloc, Lladoc, Livadicë dhe Surkish - Loto 1; Asfaltimi i rrugëve në fshatin Herticë, projekt në fazën e punimeve. Nënvizoi, gjithsejtë rrugë të asfaltuara 52. 840 km, rrugë të kubëzuara 5060 m², përkatësisht 3.2 km.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në kuadër të projekteve të planifikuara, ka kryer, përkatësisht është në fazën e përfundimit të projekteve në vijim: Ndërtimi i trotuareve në Qytet dhe fshatrat Dumnicë e Poshtme, Halabak, Batllavë, Gërdoc dhe Peran; Zgjerimi i lumit Kaqandoll, projekt dyvjeçar 2018-2019; Zgjerimi i shtratit të lumit Llap, në pjesën nga fshatrat Penuhë, Kunushec, Gllamnik, Llapashticë e Poshtme dhe e Epërme, projekt 2018-2019; Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dumnicë, lagja Rudari; Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Batllavë, lagjet Hasani dhe Bajraktari; Riparimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike; Zgjerimi dhe riparimi i ujësjellësit të Gjumnazi “Aleksandër Xhuvani” dhe në fshatin Surkish; Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Peran; Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap, vazhdimi lagja Deda deri në magjistrale, projekt 2018-2019; Zgjerimi i shtratit të lumit Llap nga Qyteti deri në fshatin Repë; Zgjerimi i lumenjve dhe përroskave në fshatin Lupç, lagja Humolli, ura në fshatin Lluzhan, në qytet, lagja Vëllezërit Frashëri, Bajçinë-lagjet Çitaku dhe Muçolli dhe në fshatin Orllan; Meremetimi i rrugëve me zhavorr; Ndërtimi i rrethojave të platosë për shërbimin e zjarrfikjes; Ndërtimi i urës në lumin Llap në fshatin Lupç i Poshtëm; Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në fshatrat Dobërdol dhe Zakut; Ndërtimi i kanalizimit fekal në qytet dhe fshatra mbi 40 lokacione në gjatësi 7.5 km; Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në fshatrat Gërdoc, Dumosh, Kalaticë dhe Shajkoc; Ndërtimi i trotuareve 2019-2020 në fshatrat Sekiraçë, Gllamnik, Tërnavë, Llugë, Gërdoc, Kaqybeg, është duke u punuar në fshatrat Bajçinë, Letancë, Revuçë, sfeçël-rruga regjionale, Llapashticë-segmenti nga dalja e qytetit, lagja Potera, magjistrallja Shajkoc; Ndërtimi i urave në fshatrat Zakut mbi lumin Llap, Sfeçël – lagja Vokri, në qytet – lagja Stublla, Babatinca; Ndërtimi i ndriçimit publik përgjatë magjstrales nga fshati Shtedim deri te pika kufitare, vazhdim në fshatin Orllan, Qytet– Peran në gjatësi 7.752 m; Ndërtimi i shtigjeve me kubëza betoni në parkun e qytetit dhe staza të shkolla e re në fshatin Batllavë; Rregullimi i shenjzimit vertikal dhe horizontal, projekt në fazën përfundimtare; Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Pakashticë e Epërme–vazhdim; Rregullimi i infrastrukturës afër varrezave në fshatrat Shajkoc, Surkish, Shakovicë, Dumnicë e Poshtme; Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjet Mbretëresha Teutë, Avdyl Lahu Majac, Peran lagjet Qosa, Oraca dhe Talla; Infrastruktura përcjellëse (kanalizimi fekal dhe ujësjellësi) lagja e Dëshmorëve; Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dumnicë – lagja Jaholli, në fshatin Llaushë – lagjet Sadiku dhe Dushkolli; Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatrat Repë dhe Pollatë projekt 2019-2020; Rregullimi i kulmeve të objekteve të banimit kolektiv; Ndërtimi i kanalizimeve fekale në fshatrat Balloc- lagja Zebica, Shabani, Batllavë–te Barainët, Dumnicë e Poshtme – lagja Uka, Mustafa, Merdar - lagja Tashevc, Letancë - lagja Plakolli, gjithsejtë 5168 m; Ndërtimi i murit mbrojtës të shkolla e re në fshatin

Batllavë; Intervenimet emergjente; Evitimi i vështirësive të kanalizimit atmosferike në fshatrat Peran, Tërnavë, Sallabajë; Kanalizimi në qytet dhe fshatra 2019-2020, Dobërdol – lagja Asllani, Katunishtë një segment në ndërtim; Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit rruga Lugu i Vogël; Ndërtimi i urave në fshatrat Peran, Obrançë- duke u punuar, Sllatinë –duke u punuar; Ndërtimi i ndriçimit publik në disa rrugë të qytetit në gjatësi prej 3.2 km.

Drejtoria e Arsimit, projektet si në vijim; Ndërtimi i objektit të shkollës “Dituria” në fshatin Llapashticë e Poshtme, projekt i përfunduar; Ndërtimi i objektit të shkollës “Elfir Behrami” në fshatin Metehi, projekt i cili do të vazhdojë edhe në vitin 2020; Ndërtimi i objektit të shkollës “Emin Duraku” në fshatin Bajçinë, projekt i përfunduar, ndërsa gjatë vitit 2020 do të vazhdojnë punimet në ndërtimin e sallës së edukatës fizike, projekt i financuar nga MASHT; Ndërtimi i objektit të shkollës “Kadri Kadriu” në fshatin Llaushë e Poshtme, projekt i financuar nga MASHT, projekt në realizim; Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të disa shkollave; Rregullimi i sallës së edukatës fizike në SHMT “Fan S. Noli” në Podujevë; Renovimi i shkollës “Kadri Kadriu”, paralelja e ndarë në fshatin Dumnice e Epërme; Riparime të pjesëshme në shkollat “Dëshmorët e Kombit dhe “Shefki Kuleta”; Ngjyrosja e shkollës “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël; Kyçja e objektit të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollën “Kongresi i Manastirit” në rrjetin e ngrohjes, ujësjellësit dhe kanalizimit; rregullimi i rrethojës dhe stazave për ecje në oborrin e shkollës “Dituria” në fshatin Llapashticë e Poshtme dhe rrethojës së shkollës në fshatin Gërdoc si dhe rregullimin e rrethojës së Çerdhës së qytetit “Armela”; Ndërtimi i dy fushave sportive në shkollat “Fan S. Noli” Podujevë dhe “Shefki Kuleta” në fshatin Tërnavë; Pajisje e dy kabinetëve me mjete mësimore në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” dhe SHFMU “Naim Frashëri” Podujevë; Makinat për pastrimin e dysHEMEVE për disa shkolla (Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”, SHMT “Fan S. Noli”, SHFMU “Naim Frashëri” dhe SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova”; Instalimi i kamerave në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani”, SHMT “Fan S. Noli” SHME “Isa Boletini”, SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova”; SHFMU “Shaban Shala” dhe çerdhen e fëmijëve “Armela”; Pajisja e disa shkollave me kompjuterë, printerë dhe projektorë.

Në sektorin e bujqësisë kemi realizuar projektet si në vijim; Ndarja e 100 serrave prej 100 m² për fermerë në lokalitete të ndryshme të Komunës, në vlerë 132, 827 €; projekti i bletarisë ku janë përfshi 100 bletarë me nga 100 shoqëri bletësh, në këtë projekt bletarët kanë participuar në shumën prej 30% të vlerës së projektit, ndërsa Komuna me 70%, vlera totale e projektit 98,500 €; Projekti i furnizimit me motokultivator për 100 fermer, po ashtu me participim prej 30 % nga ana e tyre, ndërsa Komuna me 70% të vlerës së projektit, vlera totale 134, 888 €; Projekti për analizën e tokës, projekt dy vjeçar dhe përfshinë të gjitha fshatrat e Komunës, vlera e projektit është 39,900 € dhe do të zgjasë edhe në vitet e ardhshme. Ky është një projekt i rëndësishëm sepse secili fermer do të dijë cilësinë e tokës me qëllim të përshtatjes së kulturave bujqësore; Projekti për ngritjen e pendave për ujtitje ka filluar në fshatrat Metehi (dy penda) dhe Dobërdol (5 penda), projekti është afërsisht në përfundim.

Nga Drejtoria e Administratës kemi projektin e kamerave të sigurisë në qytet, projekt dyvjeçar i cili është në fazën finale. Vlen të ceket se të gjitha hyrje-daljet e qytetit dhe brendësia do të jenë të mbuluara me kamera të teknologjisë së fundit. Në përfundim të këtij projekti do të vendosen edhe shenjatat treguese të kamerave për shkak të privatësisë pasi që jemi të obliguar sipas ligjit në fuqi; Ndërtesa e re e Komunës, sikurse jeni në dijeni është një projekt donacion nga Komisioni Evropian i dhënë për disa komuna, në mesin e të cilave ka përfituara edhe Komuna e Podujevës, projekt i cili ka filluar qysh moti, këto ditë jemi në fazën e kalimit në objektin e ri; Investimi në

Zyrat e Gjendjes Civile në terren, ku janë bërë disa rregullime të objekteve si ngjyrosje, rrethoja etj.

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ka realizuar Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit si projekt për periudhën 2019-2022; Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën 2020-2022 e cila ka kaluar fazën e debatit publik dhe pritet të miratohet në Kuvend gjatë muajit janar. Katalogu i bizneseve më të suksesshme të Komunës është i shumëzuar dhe është në dispozicion për të interesuarit; Draft Rregullorja për orarin e punës së bizneseve, dokument i cili ka kaluar fazën e diskutimit publik dhe është proceduar në Kuvend për miratim; gjatë vitit 2019 janë nxjerrë 4200 vendime për tarifa komunale.

Nga Drejtorja e kulturës Rinisë dhe Sportit janë realizuar projektet si në vijim; Fusha e hapur e futbollit të vogël në oborrin e shkollës në fshatin Balloc; Projektet në realizim janë fusha të hapura të futbollit të vogël në lagjen e Polonicëve, dhe në fshatin Sfeçël. Kryetari në vazhdim përmendi edhe aktivitetet tjera të realizuara në fushën e kulturës dhe sportit.

Në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale janë realizuar dhe janë në proces projektet; Furnizim me pajisje mjekësore të ndryshme; Ndërtimi i objektit të ri të Emergjencës 2019-2020; Blerja e një autoambulance; Ndërtimi i objekteve të ambulancave në lagjen e Dëshmorëve dhe në fshatin Obrancë, projekte në përfundim; Renovimi i objekteve shëndetësore; Ndërtimi i objektit të ri përcjellës (lavanderi, garazha, depo etj), projekt në realizim; Ndërtimi i objektit të ambulancës në fshatin Majac, projekt i realizuar dhe ndërtimi i shtëpive në lagjen e “Dëshmorëve” në fshatin Balloc, projekt i realizuar; Projekte të tjera në realizim si furnizime të ndryshme me pajisje të ndryshme, kompjuterë, furnizime tjera të nevojshme për mirëmbajtje, ngrohje, pastrim etj. Sikurse jeni në dijeni çdo vit e përkrahim edhe Handikos-in përmes subvencioneve por kemi edhe subvencionime tjera që janë të realizuara në tërësi.

Te Drejtorja e Inspeksionit, përmes QSHQ deri më sot kanë arritur 116 kërkesa të ndryshme nga qytetarët, prej tyre 103 janë shqyrtuar dhe miratuar, 3 janë hedhur poshtë, 3 janë pezulluar, 2 janë anuluar dhe 1 është në proces. Gjatë këtij viti janë kryer këto shërbime; inspektime të tregut 402 procesverbale, 32 informata dhe kërkesa të ndryshme; Inspeksioni sanitar ka hartuar 181 procesverbale, pëlqime dhe kontrole të ndryshme që janë punë të përditshme, por vlen të theksohen në mënyrë që edhe ju të jeni në dijeni që në çdo kohë të mund t’u drejtoheni institucioneve.

Gjithashtu kemi punuar edhe në lirimin e hapësirave publike duke iu referuar më shumë shitësve ambulant që pa leje përkatëse dalin në hapësira publike duke ekspozuar edhe produkte ushqimore në kushte të papranuara dhe intervenimi ynë ka qenë me qëllim të mbrojmë shëndetin e qytetarëve dhe të lirojmë hapësirat që janë të nevojshme për lëvizje dhe qarkullim, si dhe duke u ofruar shitësve kushte për punë në tregun e gjelbër, d.m.th. oferta jonë ka qenë shumë e favorshme ku për një periudhë kohore u kemi ofruar mundësi edhe pa pagesë, për të hyrë pastaj sistem. Unë nuk e kisha zgjatur më tepër sepse ka edhe shumë çka të thuhet por edhe njëherë ju falënderoj për pjesëmarrje. Besoj se edhe ju do të kontribuoni me vlerësimet e juaja. Unë ju kërkoj falje që nuk mund të vazhdoj me takimin, pasi që më duhet të jem në një takim të paparalajmëruar.

Pasi që jemi në përfundim të vitit ju uroj festat e fund vitit.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, pasi që është debat me qytetarë do të shfrytëzojmë kohën në maksimum për diskutime, vlerësime, kritika etj. Të gjitha pyetjet që i adresoni, përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme rreth projekteve do të jepen nga ana e Drejtorëve të Drejtorive të cilët janë prezentë. E hapi debatin.

z. Kadri Halili, nga fshati Sfeçël, theksoi, kemi projektin e paguar qe 5 vite për një rrugë në fshatin Sfeçël por ende nuk është bërë asgjë. Kur mund të fillohet me realizimin e atij projekti.

z. Mustaf Sherifi, nga fshati Balloc, theksoi në fshatin Balloc është punuar në infrastrukturë rrugore por ende ka rrugë që duhet rregulluar. Kërkesa është për asfaltimin e një rrugice të fshatit që shpie deri te shtëpia ime në gjati prej 100 m. Gjithashtu dua të ju informoj se duhet të vendosen dy kapakë të ri të pusetave pasi që janë thyer.

z. Arben Çitaku nga fshati Bajçinë, theksoi, për një kanalizim për të cilin kemi bërë kërkesë, sa jam i informuar tani është shpallur tenderi, pyetja është se kur mund të realizohet ky projekt. Po ashtu kemi një kërkesë tjetër të banorëve të lagjes Çitaku për ndërtimin e një pende për ujitje pasi që është një pjesë bukur e madhe e tokës bujqësore që ka nevojë për ujitje.

z. Faik Kajtazi, përfaqësues i fshatit Pakashticë, theksoi, është e vërtetë se është punuar bukur shumë në shumë fusha por gjithashtu kemi ende disa kërkesa të banorëve për investime në infrastrukturë. Kërkesat janë: Asfaltimi i një rruge në gjatësi prej 250 m dhe ndërtimin e murit mbrojtës prej lumit; Ndërtimi i trotuarit në gjatësi prej 500 duke filluar nga objekti shkollës deri në brendi të fshatit; Ndërtimin e kanalizimit fekal për një lagje (25 familje) e cila deri më tani ka mbetur jashtë rrjetit për shkak të pengesave pronësore; Të bëhet hapja e kanaleve në hyrje te pishat për shkak se uji gjatë shirave është duke rrezikuar dëmtimin e asfaltit dhe mundësisht të hedhet edhe ca zhavorr në atë pjesë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, të nderuar ju kisha lutur që mundësisht të koncentrohemi në temë, flisni më tepër për projektet që janë realizuar, nëse keni ndonjë pakënaqësi, nëse nuk është realizuar mirë apo është vonuar etj. e jo për projeksionet e vitit 2020. Për projeksionet e vitit 2020 janë mbajtur tubime me qytetarë ku ju keni propozuar, ne i kemi marrë propozimet e juaja dhe të njëjtat janë miratuar në Kuvend dmth. planifikimi për vitin 2020 është i përfunduar andaj fokusohuni në temën “ Projektet e realizuara në vitin 2019” dhe mundësisht sa më shkurtër.

z. Agron Hetemi, theksoi jam banorë i lagjes së Dëshmorëve dhe dua të paraqesë një ankesë për shkak të dëmtimit të rrugës, prerjes në shumë segmente të asfaltit për vendosjen e kablllove të rrjetit të energjisë elektrike. Pyetja është se si mund të lejohet një gjë e tillë. Përndryshe Kryetarit të Komunës i jemi shumë mirënjohës dhe e falënderojmë për ndihmën që na ka dhënë dhe investimet që ka bërë në lagjen e Dëshmorëve, duke veçuar ndërtimin e shtëpive të reja dhe të ambulancës. Pse inspeksioni i Komunës nuk del apo pse lejon dëmtimin dhe prerjen e rrugës në atë masë, sepse neve po na kushton me dëmtimin e automjeteve.

z. Rexhep Dauti, përfaqësues i fshatit Llaushë, theksoi Drejtori i DSHPMSH ka bërë një punë të shkëlqyer në lagjen Sadiku me ndërtimin e rrjetit të kanalizimit fekal, e që vitin e ardhshëm do të shtrihet edhe në lagjen Dushkolli. Plotësisht jemi të kënaqur me këto projekte, megjithatë kam edhe një kërkesë për asfaltimin e një rruge për lidhjen e fshatrave Llaushë dhe Dobërdol, e cila ka bazën që nga viti 2012. Gjithashtu kemi kërkesa për asfaltimin e rrugicave të fshatit, sepse kemi shumë nevojë, janë mbi 3000 m rrugica.

z. Fadil Gërguri, nga fshati Sibofc i Poshtëm, theksoi, dua të pyes Drejtorin e DSHPMSH z. Faik Muçiqi për vazhdimin e pastrimit të lumit për shkak se një kohë kanë ngecur për shkak të disa pengesave që i kanë bërë banorët, pyetja është se a do të vazhdoj ky projekt. Kohë më parë pata bërë një kërkesë për shtruarjen me zhavorr të rrugës për në fshatin Kaqybeg, jemi në pritje.

z. Enver Berisha, nga fshati Kunushec, theksoi kam një kërkesë për asfaltimin e një rrugice në lagjen Fazlia, është bukur një kohë që na është premtuar. Rugica është riparuar me zhavorr nga Komuna, por dua të di se a është në plan për asfaltim vitin e ardhshëm.

z. Shaban Menxhiqi, nga fshati Lupç i Epërm, theksoi kam dy vërejtje të vogla sa i përket zgjerimit të lumit Kaqandoll, nuk është zgjeruar si duhet, mendoj se këtu fajtor janë edhe vet fshatarët me ndërhyrjet e tyre. Tjetra është te kanalizimi i ujërave të zeza, gypat e vendosur në shtratin e lumit janë shpluar dhe në disa vende janë dëmtuar-shpërthyer. Çështja është nëse ka mundësi të bëhet ndonjë përmirësim.

z. Rrahman Shala, nga fshati Bajçinë, shtroi kërkesë për asfaltimin e një rruge. Theksoi kjo daton që nga viti 2015 dhe në atë rrugë kemi dalje 12 shtëpi.

z. Sahit Osmani, nga fshati Dumnicë e Epërme, shprehu falënderimet për Ekzekutivin e Komunës për investimet e bëra, përkatësisht për asfaltimin e rrugës nga lagja Jaholli – fshati Llaushë si dhe për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit, megjithatë theksoi, kam një kërkesë për vazhdimin e asfaltimit nga lagja Jaholli deri te shkolla e fshatit Dumnicë e Epërme

z. Fatos Delia, përfaqësues i fshatit Penuhë, theksoi, si përfaqësues i fshatit kam disa kërkesa; Asfaltimi i rrugicës në lagjen Toshi, e cila ka qenë në projekt të asfaltohet këtë vit por ende nuk është bërë; Ndriçimi i rrugës kryesore të fshatit; Asfaltimin e disa rrugicave tjera nëpër lagje të fshatit; Instalimin e një gypi të ujësjellësit për lagjen Zhdredha.

z. Sahit Uka, përfaqësues i fshatit Obrançë, theksoi, ndërtimi i katit të sipërm të shkollës në fshatin Obrançë ka qenë në projekt këtë vit por ende nuk është bërë, kërkesa është gjithashtu për shtrirjen/vazhdimin e trotuarit deri te shkolla, janë diku rreth 400 m.

z. Vehbi Podvorica, përfaqësues i fshatit Dumosh, kam disa kërkesa, njëra që përsëritet pothuajse 5 vite për asfaltimin e një rruge te lagja Vokri, në gjatësi prej 1200 m, është shumë e nevojshme dhe e kërkuar prej qytetarëve; Rregullimin me zhavorr të një rrugice për familjen e Fadil Podvoricës; Ndriçimin te shkolla e fshatit dhe ndërtimin e një fushe të vogël sportive.

z. Zymer Kadriu, nga fshati Dumnicë e Epërme, kemi nevojë për asfaltimin e një rruge deri te shkolla dhe prej shkolle nëse nuk ka mundësi për asfaltim së paku të rregullohet me zhavorr dhe të zgjerohet. Arat ne i punojmë përmes asaj rruge.

z. Fadil Berisha, përfaqësues i fshatit Kunushec, theksoi në fshat këtë vit janë kryer disa projekte mjaft të rëndësishme ashtu sikurse kanë qenë të planifikuara, ku edhe falënderoj organet komunale për punën e tyre, megjithatë kemi kërkesë dhe nevojë për asfaltimin e edhe të disa rrugicave tjera, disa edhe me zhavorr.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, patëm shumë pyetje, besoj se Drejtorët e Drejtorive i kanë evidentuar për të dhënë përgjigje. Fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit- DPUMM z. Hamdi Jaha.

z. Hamdi Jaha, drejtor i DPUMM, theksoi, Kryetari prezantoi komplet projektet e realizuara dhe në realizim e sipër. Në kuadër të projekteve, një numër i tyre janë projekte dy vjeçare, por ka edhe projekte ku pjesëmarrës në investime kanë qenë Ministrinë e Linjës. Drejtori në vazhdim, në detaje foli për procesin e realizimit të projekteve, për ato në proces të realizimit, por gjithashtu foli edhe për ngecjet dhe sfidat e paraqitura, për planin dinamik të realizimit të tyre, koston financiare, si dhe për lokacionet apo vendet ku janë realizuar si dhe dha përgjigje në kërkesat e paraqitura nga pjesëmarrësit. Nënvizoi, dua të theksoj se ende kemi disa rrugë të gjata, përveç tjerash edhe me rëndësi ekonomike. Kemi rrugën për në fshatin Metergoc në gjatësi 10 km, ku 8 fermerë të cilët kanë 250 krerë lopë nuk kanë mundësi të

shpërndajnë qumështin dhe është kërkesa që Komuna t'u mundësojë që ata së paku të kenë lëvizje, apo në fshatin Kushevicë, rruga në gjatësi 7 km.

Theksoi, jemi afër të përfundimit të infrastrukturës rrugore të Komunës së Podujevës. Kërkesat e Juaja për rrugë dhe rrugica me gjatësi afërsisht 50-100 m nëpër lagje, kjo është një tregues i mirë se jemi afër përmbylljes së investimeve në infrastrukturë rrugore.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit; theksoi, Kryetari i Komunës në përgjithësi ju njoftoi me projektet nga fushëveprimi i kësaj Drejtorie. Buxheti deri më tani është afër 90% të shpenzimit, ku besoj se këto ditë brenda afatit të pagesave do ti ofrohemi maksimales së shpenzimit.

Drejtori foli për projektet e kanalizimeve dhe kolektorëve, projektin e trotuareve, ndriçimin, pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve, rrugët me zhavorr, etj. për gjendjen aktuale dhe për planin dinamik të realizimit të tyre, koston financiare, si dhe për lokacionet apo vendet ku janë duke u realizuar projektet, si dhe dha përgjigje në kërkesat dhe vërejtjet e paraqitura nga ana e pjesëmarrësve.

z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; theksoi, sa i përket pyetjes së përfaqësuesit të fshatit Obrançë rreth mbindërtimit të shkollës së fshatit, kjo është duke u vlerësuar nga ana e inxhinierëve, e pastaj do të shohim dhe do të procedojmë më tutje.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, unë vetëm desha të shfrytëzoj rastin të ju informoj edhe për një projekt të Komunës që është edhe projekti kryesor dhe është në zhvillim e sipër, fjala është për projektin; Ndërtimi i kolektorit kryesor për grumbullimin e ujërave të zeza, projekt i cili realizohet me kredi të butë që kemi marrë nga Banka Austriake. Deri më tash janë kryer afër 3 km, ku është duke shkuar shumë mirë dhe me këtë ritëm presim që projekti të përfundoj para afatit të paraparë. Do të bëhet një zgjidhje shumë e mirë për lumin Llap por edhe për lumenjtë tjerë. Deri në fillim të vjeshtës së vitit të ardhshëm pritet që komplet projekti për grumbullimin e ujërave të zeza në territorin e Komunës së Podujevës të përfundoj.

Ne me këtë e përmbyllim takimin dhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 12.30

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/01-0093813/19
Podujevë, 17 dhjetor 2019**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**